

# TRAJTIMI ME RESPEKT DHE NDJESHMËRI I VIKTIMAGE TË KRIMEVE TË URREJTJES

## VIKTIMIZIMI I SËRISHËM

Viktimizimi i sërishëm ose riviktimizimi ndodh për shkak të trajtimit të papërshtatshëm të viktimave nga personat që kanë kontakt me to. Për të parandaluar riviktimizimin e viktimave të krimeve të urrejtjes, është thelbësore që kushdo që bie në kontakt me një viktimë të një krimi urrejtjeje të jetë i vetëdijshëm për paragjykimet personale dhe të kuptojë se si ndikojnë krimet e urrejtjes te viktimat dhe te komunitetet, si dhe sa të ndjeshëm janë viktimat ndaj viktimizimit të përsëritur.

## TRAJTIMI ME RESPEKT DHE NDJESHMËRI NË PRAKTIKË

Kontakti fillestar i zyrtarit policor me viktimën e krimit të urrejtjes është një nga momentet më të rëndësishme dhe kritike në ndërveprimin e viktimës me sistemin e drejtësisë penale.

Përfundimet që nxjerr viktimat nga ai takim i parë mund të ndikojnë në mënyrën se si ajo e percepton tërë sistemin e drejtësisë dhe në gatishmërinë e saj për ta raportuar rastin, për të bashkëpunuar dhe për të dhënë detaje të rëndësishme faktike, ndonjëherë edhe intime.

## PSE ËSHTË KAQ E RËNDËSISHME KJO PËR VIKTIMAT E KRIMEVE TË URREJTJES

Një nga arsyet për nënraportim të krimeve të urrejtjes është perceptimi i viktimës se nuk do të trajtohet me seriozitet. Gjithashtu, shumë viktimat të krimeve të urrejtjes mund të kenë frikën se autoritetet do t'i kenë të njëjtat paragjykimet sikurse kryerësi. Është me rëndësi të madhe që profesionistët e drejtësisë penale të marrin veprime pozitive për të siguruar që viktimat e krimeve të urrejtjes trajtohen me respekt dhe ndjeshmëri.

Është përgjegjësi e të gjithë profesionistëve të drejtësisë penale që punojnë me viktimat e krimeve të urrejtjes që të marrin masa që viktimat të trajtohen me respekt dhe ndjeshmëri. Prandaj, ndërtimi i një kulture të trajtimit me respekt dhe ndjeshmëri kërkon përfshirjen e të gjitha agjencive dhe aktorëve.


Trajtimi me ndjeshmëri dhe respekt mund të ndihmojë në rritjen e besimit dhe të kontribuojë në krijimin e një përvoje të përgjithshme pozitive nga ana e viktimave në procesin e drejtësisë penale, duke i fuqizuar ato që t'i japin provat më të mira dhe kështu të parandalohet riviktimizimi i tyre brenda dhe jashtë këtij procesi.

### Kur kanë të bëjnë me raste që mund të jenë krime urrejtjeje, punonjësit e zbatimit të ligjit duhet gjithmonë të:

- ✓ Jenë në dijeni për karakteristikat e mbrojtura dhe mënyrën se si karakteristikat e shumta shpeshherë ndërthuren, për t'u siguruar se arrijnë t'i identifikojnë si duhet viktimat e krimeve të urrejtjes.
- ✓ Të aplikojnë qasje me fokus në viktimën kur reagojnë në incidente të krimeve të urrejtjes.
- ✓ Respektojnë perceptimin e viktimës se kryerësi ka vepruar i nxitur nga paragjykimi.
- ✓ Kenë parasysh nevojën më të lartë për mbrojtje, bazuar në perceptimin e viktimës.

**Bazat e trajtimit me ndjeshmëri dhe respekt nga punonjësit e zbatimit të ligjit në kontaktin e parë me viktimat e krimit të urrejtjes:**

- ✓ Të merren masa për ta ndarë viktimën nga kryerësi dhe për ta vendosur viktimën në një mjedis të sigurt dhe të veçuar.
- ✓ Ta informojnë viktimën për të drejtat e saj dhe për mbështetjen që mund të marrë si viktimë e krimit të urrejtjes.
- ✓ Të fillojnë procesin e vlerësimit të nevojave individuale (VNI) për t'i identifikuar nevojat e atypëratyshme të sigurisë, për të identifikuar rrezikun e viktimizimit të mëtejshëm, frikësimit ose hakmarrjes, si dhe për referimin e tyre te profesionistët e kualifikuar për ofrimin e mbështetjes.
- ✓ Të identifikohen nevojat për komunikim. Të merren masa për të garantuar respektimin e të drejtave të viktimës për të pasur përkthyes, avokat dhe/ose një person tjetër sipas përzgjedhjes së viktimës gjatë intervistës dhe në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale.
- ✓ Të dokumentohen saktë deklaratat e viktimës, duke përfshirë çdo perceptim të motivit paragjykses të kryerësit. Të inkurajohet viktimat që me fjalët e veta të tregojnë se çfarë ka ndodhur.
- ✓ Të informohet viktimat për hapat e ardhshëm që mund të ndërmerren gjatë hetimit.



**Me qëllim të zbutjes së riviktimizimit të mundshëm, duhet të përdoren këto praktika komunikimi:**

- ✓ Zyrtarët policorë duhet të jenë të vëmendshëm gjatë gjithë kohës për tonin e zërit që përdorin, gjuhën e trupit dhe llojin e gjuhës që përdorin, si dhe mënyrën se si mund të perceptohet ajo.
- ✓ Zgjidhni fjalët me kujdes dhe mos përdorni gjuhë diskriminuese ose fyese, madje as zhargon apo barcoleta të pahijshme.
- ✓ Kujdesuni që të mos bëni supozime për statusin martesor, socio-ekonomik apo për vendbanimin, si dhe mos bëni supozime për sjelljen e tyre bazuar në nocionet e perceptuara të fesë, besimit ose kulturës së tyre.
- ✓ Pyeteni personin se si dëshiron që t'i drejtoheni, në vend që ta supozoni identitetin gjinor, si dhe përdorni gjuhë përfshirëse.
- ✓ Komunikoni me viktimën në një gjuhë të kuptueshme dhe përgjigjuni çdo pyetjeje që mund të ketë viktimat.
- ✓ Dëgjojeni në mënyrë aktive dhe kushtojini vëmendje situatës së viktimës, si për shembull duke mos e ndërprerë, por përkundrazi, duke ia bërë më të lehtë përshkrimin e situatës, pa e penguar.



Për të mësuar më shumë, ju lutemi referojuni **[Udhëzuesit Model të EStAR për trajtimin me respekt dhe me ndjeshmëri të viktimave të krimeve të urrejtjes në sistemin e drejtësisë penale](#)** dhe **[Kursit të trajnimit për profesionistët e drejtësisë penale për trajtimin me sukses dhe me ndjeshmëri të viktimave të krimeve të urrejtjes](#)**.



Projekti "Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve dhe shtimi i burimeve për mbështetjen e viktimave të krimeve të urrejtjes (EStAR)" është bashkëfinancuar nga Programi i Bashkimit Evropian për të Drejtat, Barazinë dhe Qytetarinë (2014-2020) dhe nga Qeveria Federale e Gjermanisë.

